



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1109/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkelzen Xhaferi kandidat për asamble të kuvendit komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Vushtri, paraqitur kundër komisionerit Armend Saraçi, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Shkelzen Xhaferi kandidat për kuvendin komunal në Vushtri nga radhët e subjektit politik LDK.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Shkelzen Xhaferi anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik LDK dega në Vushtri, i cili konsideron se ju kanë marrë votat nga komisioneri i partisë së tij në sallën 2702b/03R si dhe në shkollën “Ali Kelmendi” në Vushtri, ai kërkon që të bëhet rinumrimin i votave të tij në këto vendvotime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkrësat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Shkelzen Xhaferi anëtarë për asamble në komunën e Vushtrisë. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1109/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.